

HOMELIA ZOJA E SHKODRËS

17/10/2022

Imzot Angelo Massafra O.F.M.

Arqipeshkëv

Festa e sotme ka një karakter jashtëzakonisht familjar, sepse ka të bëjë me Pajtores e qytetit të Shkodrës dhe, aq më tepër, me këtë bashkësi famullitare. Kështu, përveç vazhdimit të kremtimit të kësaj feste tradicionale të qytetit tonë, kemi dashur të kthejmë në ditët tona edhe të vërtetën historike të së shkuarës: në fakt, kjo famulli e lidhur me kishën katedrale ka pasur gjithmonë titullin e Zojës së Shkodrës dhe, vetëm për një keqkuptim, për disa vite me radhë ajo është quajtur me emrin e Shenjtës Pajtor të dioqezës, Shën Shtjefnit protomartir.

E kremtojmë, pra, me një entuziazëm të përtërirë këtë festë për famullinë që ka rizbuluar të vërtetën historike të Pajtores së vet dhe festë e krejt qytetit, me të gjithë përbërësit e saj kishtarë: famullitë, kishat e tjera, Urdhrat dhe Kongregatat rregulltare që veprojnë këtu, laikët katolikë të Shoqatave dhe të Lëvizjeve, me apostullimin e tyre të krishterë. Me arsye mund të themi se Maria, Nëna e Kishës (një titull i bukur që Papa Françesku ka dashur që të bëhej një përkujtim liturgjik i vendosur të hënën pas Rrëshajëve), na mblodhi të gjithëve si Kishë, bashkësi e Krishtit të Ngjallur.

Jemi Kishë rreth Nënës së Zotit, ashtu si nxënësit dhe apostujt u mblodhën rreth Marisë pas Ngjalljes së Jezusit, në lutje të zjarrtë dhe me dëshirën për jetën e përbashkët dhe veprat e mëshirës. Po ju bëj një pyetje: a nuk është kjo përvoja që Papa Françesku na kërkon të bëjmë përmes kremtimit të Sinodit? Përvoja sinodale ka të bëjë me rizbulimin e ndjenjës së të qenit Kishë, të gjithë së bashku, pa ua besuar vetëm barinjve detyrën për të ndjerë krejt përgjegjësinë. Është e vërtetë shprehja: “Ose shpëtojmë bashkë, ose askush nuk shpëton!”.

Tragjedia e pandemisë na ka bërë të përjetojmë se si, vetëm falë bashkëpunimit të të gjithëve, mund të shpëtojmë; dhe sot, përballë fantazmës së luftës, kërcënimeve që synojnë lirinë e shprehjes, mohimit të të drejtave të grave në disa pjesë të botës, dhunës gjithnjë në rritje në qytetin tonë, të cilat gjej rastin t'i dënojnë ashpër, vetëm nëse jemi të bashkuar mund të dalim prej saj dhe të rizbulojmë gëzimin e të jetuarit.

Ngushëllimi dhe forca e nxënësve dhe e apostujve të mblodhur në Çenakull ishte prania e Marisë, një prani që ngjall një ndjenjë të fortë feje, atë fe që e bënte të besonte fort në premtimin e Zotit në Ngjallje. Dhe pas ngjalljes së Birit të saj, prania e nënës në jetën e Kishës së parë nxiste në pritjen me besim të dhuratës së Shpirtit Shpejt.

Kjo vlen edhe për ne: nuk mund dhe nuk duhet ta humbasim shpresën, por me forcën e fesë, duke qenë të bashkuar dhe duke u shtrënguar rreth Nënës së Jezusit, mund t'i kapërcejmë vështirësitë e kohës së tanishme dhe t'i hapemi shpresës për një të ardhme më të mirë për botën tonë, Evropën tonë, atdheun tonë dhe qytetin tonë. Kështu vepruan edhe baballarët tanë, të cilët, në kohë shtypjeje, qoftë edhe të kërcënuar, gjetën guximin të ecnin mbi rrënojat e Shenjtërores së Shkodrës, të sigurt për ndihmën e Marisë; ndihmë që nuk mungoi. Kështu duhet të bëjmë edhe ne!

Dhe, gjithmonë të fortë prej inkurajimit të Nënës që thotë: “Bëni çfarë ju thotë ai”, apostujt largohen nga çenakulli dhe bëhen Kishë në dalje, siç na nxit edhe sot të jemi Papa Françesku. Po jetojmë muajin kushtuar reflektimit, lutjes dhe bashkëveprimit misionar. Nuk mund ta quajmë veten 'Kishë' nëse nuk e ndiejmë këtë shtysë të Shpirtit Shenjt për të dalë, për të dëshmuar, për të shpallur me zë të lartë bukurinë që i përkasim Krishtit. Dhe duke e bërë këtë, duhet pasur kujdes që ta bëjmë së bashku, si një bashkësi, duke identifikuar format e dëshmisë së sinqertë, domethënë që niset nga e vërteta e jetës sonë të bashkuar me Krishtin, dhe jo vetëm forma të jashtme që më pas rrezikojnë të mos ndeshen në jetën e përditshme të secilit. Duhet të jemi dëshmitarë dhe jo mësues, sepse të gjithë jemi nxënës të këmbët e të vetmit Mësues, Krishtit. Shën Pali VI thotë: “*Njeriu bashkëkohor i dëgjon me më shumë dëshirë dëshmitarët, sesa mësuesit, ose nëse i dëgjon mësuesit e bën sepse ata janë dëshmitarë*” (Evangjeli nuntiandi, 41).

Në thelb, kjo është sinteza e Mesazhit që Papa Françesku u dërgoi të gjithë të krishterëve me rastin e Ditës Botërore Misionare të këtij viti; mesazh që përfundon me këto fjalë shumë të forta: “*Të dashur vëllezër dhe motra, vazhdoj ta ëndërroj Kishën krejt misionare dhe një stinë të re veprimi*

misionar për bashkësitë e krishtera. Dhe përsëris urimin e Moisiut për popullin e Hyjit në rrugën e tyre: "Eh, po të ishte e mundur që i tërë populli të profetizojë e Zoti t'ia jepte Shpirtin e vet!" (Nm 11,29). Po, sikur të ishim të gjithë ne në Kishë ashtu siç jemi për virtyt të pagëzimit: profetë, dëshmitarë, misionarë të Zotit! Me fuqinë e Shpirtit Shenjt dhe deri në skajet e tokës. Mari, Mbretëreshë e misioneve, lutu për ne!"

Vëllezër dhe motra, po kujtoj në këtë kontekst fjalët përmbyllëse të Dokumentit që Komisioni Kombëtar i Sinodit në Shqipëri ka hartuar dhe ka dorëzuar në Sekretariatit e Përgjithshëm në Vatikan. Këto janë fjalë që disi kanë të bëjnë me gjithë jetën kishtare të popullit tonë, por në mënyrë të veçantë me kuptimin misionar. Dokumenti mbyllet kështu: *"Gjëja që më së shumti ka dalë në pah dhe që përbën një mendim vërtet të fortë është forca e paragjykimit social dhe lehtësia për të deleguar përgjegjësitë personale tek të tjerët, në veçanti meshtarëve dhe baskëpunëtorëve të tyre (ky është mendimi tipik klerikal i pranishëm tek besimtarët dhe te shumë meshtarë)".*

Uroj që ju dhe unë të ecim vërtet së bashku, në kapërcimin e kësaj mendësie, duke u ndierë vërtet të gjithë bashkëpërgjegjës në zhvillimin e jetës kishtare, duke braktisur interesat private në favor të së mirës së përbashkët.

T'ia besojmë veten ndërmjetësimit të fuqishëm të Marisë, Pajtores sonë, dhe t'i kërkojmë asaj që të marrë për ne nga Biri i saj Jezus hirin për të qenë nxënës të vërtetë të tij, gjymtyrë aktive të Kishës, misionarë të zjarrtë dhe dëshmitarë të singertë të Tij, të cilit i qoftë nderi dhe lavdia në shekuj të shekujve. Amen.

Zoja e Shkodrës, lutu për ne.